

INTEGRIMI I BOTËKUPTIMIT ISLAM

Njeriu sheh, interpreton dhe sillet ndaj botës ashtu siç beson se bota është ose për çfarë është ajo. Kjo pasuri aspektesh për të vërtetën e jetës njihet ndryshe si botëkuptim. Në këtë këndvështrim, botëkuptimi është një përmbledhje e aspekteve kryesore rreth realitetit që qëndrojnë në themel të jetës dhe ndikojnë në të gjithë perceptimin, të menduarit, të diturit dhe të bërit. Sipas përshkrimit të Eugene Nida-s, botëkuptimi është një “...sistem vlerash” me të cilin një popull karakterizohet e shikon universin. Është një studim i botës, është një pamje e jetës.¹

Fjala “botëkuptim”, ashtu siç mund ta shohim edhe nga Fjalori i gjuhës shqipe përkufizohet si

“Tërësia e pikëpamjeve të njeriut për botën që e rrethon, sistemi i pikëpamjeve që ka njeriu për jetën, për natyrën dhe për shoqërinë; të kuptuarit e botës, të realitetit”.

Në fakt, përkufizimi i këtij termi në mënyrë precize është i vështirë. Duke qenë se termi botëkuptim është përdorur për herë të parë nga Kanti si “*Weltanschauung*”,² shohim se ai e ka përkufizuar këtë si perceptim i botës përmes shqisave, apo siç u adaptua dy vite më vonë nga dishepulli i tij Johann Gottlieb Fichte si “*perceptimi i botës së ndjeshme*”.⁴ Ndërkaq Heideger sugjeron se filozofia dhe botëkuptimi janë thuajse e njëjta gjë, duke thënë se “*të gjitha filozofitë kulmojnë në botëkuptim*”.⁵ Andaj edhe botëkuptimit mund t’i referohemi si filozofi, si filozofi e jetës, mendësi, pikëpamje për jetën, formulë për jetën, ideologji, filozofi e besimit apo

1 Muhammad Abdullah & Muhammad Junaid Nadvi, “Understanding the Principles of Islamic World-View”, (*The Dialogue*, v. VI Number 3), f. 270.

2 <http://www.fjalori.shkenca.org>.

3 Gjermanisht, nga *Welt që do të thotë botë “Anschauung” që do të thotë “pamje”*. Për një analizë më të detajuar të termit në gjuhën gjermane, dhe përdorimit nga Imanuel Kant si dhe përdorimit të tij në gjuhët tjera europiane shiko David K. Naugle, *Worldview: “The History of a Concept”* (Michigan: Wm. B. Eerdmans Publishing, 2002) f. 55-67.

4 David K. Naugle, “*Worldview*”, *po aty*, f. 60.

5 David K. Naugle, “*Worldview*”, *po aty*, f. 134.

edhe si fe.⁶

Janë dhënë definime të ndryshme në librin e David Naugles që trajton historikun e këtij koncepti. Ai shkruan se kjo fjalë parë nga perspektiva historike ka marrë kuptime të ndryshme, por përgjithësisht ideja e botëkuptimit është një mënyrë se si një person apo grup e shikon botën. Naugles pasi shkruan për rreziqet dhe përfitimet nga botëkuptimi, na jep një përkufizim me anë të të cilit shpreh edhe një ide me plotë për botëkuptimin që duam ta prezantojmë këtu.

“Në fund të fundit, çfarë mund të jetë më e rëndësishme ose me ndikim sesa mënyra se si një individ, një familje, një komunitet, një komb ose një kulturë e tërë koncepton realitetin? A ka ndonjë gjë më të thellë ose të fuqishme sesa forma dhe përmbajtja e vetëdijes njerëzore dhe interpretimi i saj kryesor i natyrës së gjërave? Kur bëhet fjalë për pyetjet më të thella në lidhje me jetën dhe ekzistencën njerëzore, a i tejkalon ndonjë gjë implikimet përfundimtare të përgjigjeve të dhëna nga një “Weltanschauung” thelbësor?”⁷

Njeriu duhet të përgjigjet për disa pyetje themelore në lidhje me ekzistencën përreth tij, sepse kjo do t'i mundësonte një personi ose një shoqërie të jetonte një jetë që do të kishte kuptim, qëllim dhe harmoni në udhëtimin e saj.⁸ Pra, botëkuptim do të thotë të zbulosh thelbin, qenien tonë më të brendshme dhe një orientim drejt të cilit do të bazohet sjellja jonë. Njeriu është i prirur të zbulojë dimensionet e tij humane, të kërkojë lirinë në ekzistencën e tij, duke i marrë aspektet e kësaj ekzistence në kontroll. Ky kontroll shtrihet sa në dimensionet e brendshme, aq edhe në dimensionet e jashtme. Ky kontroll nënkupton një zhvillim brenda njeriut që e shpëton atë nga subjektivizmi i jashtëm dhe i brendshëm, duke e bërë atë të lidhur me një doktrinë ose me një besim të caktuar.⁹ Shprehur me fjalët e Ebu Sulejmanit:

“Asnjëherë në histori një komb nuk ka jetuar në mënyrë krijuese, me qëllim dhe në mënyrë konstruktive përveç nëse për shkak të dinamizmit të vizionit të tij për veten dhe botën përreth tij.

6 Muhammad Abdullah & Muhammad Junaid Nadvi, “Understanding the Principles of Islāmic World-View”, *po aty*, f. 270.

7 David K. Naugle, “Worldview”, *po aty*, f. 345.

8 Për disa nga pyetjet më themelore që më pas përkufizojnë dhe dallojnë botëkuptimet nga njëri-tjetri shikoni librin e James N. Anderson, “What’s your Worldview? An Interactive Approach to Life’s Big Questions” (Crossways: Wheaton, Illinois, 2014) f. 16.

9 Ky zhvillim nënkupton edhe individin, edhe një shoqëri të caktuar. Shiko Murtaza Mutahhari, “Hyrje në botëkuptimin Islam” (*Tetovë: Gnosa, 2017*) Vëll. I, bot. i dytë, f. 16.

Anasjelltas, asnjëherë në histori një komb nuk ka mbetur prapa dhe i ngurtësuar, përfundimisht duke u shpërbërë dhe duke rënë në harresë, veçse si rezultat i pasivitetit dhe natyrës së shtrembëruar të botëkuptimit të tij”.¹⁰

Botëkuptimi nënkupton një vizion të jetës përmes të cilit ne mund të gjykojmë, interpretojmë dhe fitojmë njohuri përmes saj. Njohuritë e marra nxjerrin në pah pikturën madhështore të jetës, dhe ne përqipemi të njohim kuptimin e ekzistencës nga njëra anë, si edhe vendin dhe rolin tonë në të, nga ana tjetër. Nga ky botëkuptim, përveç njohurive, synohet të përfitohen vlerat dhe konceptet themelore, me anë të të cilave synohet të arrihet një harmoni më e plotë gjatë ditës. Duke e parë në aspektin psikologjik, për të arritur këtë harmoni gjatë ditës, Freudi do ta përkufizonte botëkuptimin si një hipotezë që do të ofronte përgjigje për të gjitha problemet apo pyetjet tona, duke vënë çdo gjë në vendin e vet. Kur njeriu arrin ta realizojë këtë, atëherë ai ndihet i sigurtë, di se çfarë të bëjë dhe si duhet të menaxhojë ndjenjat dhe interesat e tij. Pra, sipas tij, kjo “hipotezë” është një ideal për të cilin njeriu ka nevojë dhe tek i cili mund të gjejë paqe me mendjen e tij, duke i mundësuar të mësojë se si të merret me jetën në rrugë praktike.¹¹ Kjo është një kërkesë e çdo qenieje njerëzore dhe e çdo shoqërie, aq sa nëse duam të kuptojmë natyrën e një kulture mjafton të kuptojmë se mbi çfarë vizioni e ka orientuar dhe shprehur veten.

“Çdo sistem kulturor shoqërohet me një botëkuptim themelor, i cili përkthehet në veprim me anë të një mënyre të veçantë të të menduarit ose mendësisë. Në mënyrë të ngjashme, çdo mënyrë e të menduarit shoqërohet me parime udhëzuese që shërbejnë për të përcaktuar rezultatet e saj... Si pasojë, asnjë mënyrë e të menduarit - duke përfshirë parimet e saj përbërëse, vlerat dhe konceptet - mund të jenë efektive nëse nuk bazohet në një pamje të ndërtuar mirë, pozitive, koherente të botës dhe kulturës, bazat dhe qëllimet e së cilës janë përcaktuar qartë dhe që është ngulitur fort në mendjet dhe ndërgjegjet e anëtarëve të shoqërisë. Ky është lloji i botëkuptimit dhe mënyrës së të menduarit që mund të bëhet burim i dinamizmit dhe mirëqenies si në nivelin individual ashtu edhe në atë shoqëror”.¹²

Kjo mënyrë e veçantë e të menduarit dhe e mendësisë ndryshon nga njëra kulturë në tjetrën në varësi të asaj se çfarë ai botëkuptim merr si

10 Abdulhamid Abu Sulayman, “The Quranic Worldview: A Springboard for Cultural Reform” (London: IIIT, 2011) f. 26.

11 David K. Naugle, “Worldview”, f. 213.

12 Abdulhamid Abu Sulayman, “The Quranic Worldview”, po aty, f. 1-2 (26-26).

përfundimisht të vërtetë dhe reale.¹³ Charls Kraft i përmbledh mjaft mirë aspektet filozofike, konceptet dhe formën që merr kultura nga një botëkuptim:

*“Perceptimet e realitetit janë modeluar nga shoqëritë në konceptualizime të asaj që mund ose duhet të jetë realiteti, çfarë duhet të konsiderohet si aktuale, e besueshme, e mundshme dhe e pamundur. Këto konceptualizime formojnë atë që quhet botëkuptimi i kulturës. Botëkuptimi, pra, sipas këtij modeli, është sistematizimi qendror i koncepteve të realitetit, për të cilat pajtohen anëtarët e një shoqërie (kryesisht në mënyrë të pavetëdijshme), dhe nga i cili buron sistemi i tyre i vlerave. Botëkuptimi qëndron në zemër të një kulture, duke prekur, bashkëvepruar me dhe duke ndikuar fuqimisht në çdo aspekt tjetër të kulturës”.*¹⁴

Sipas këtyre përkufizimeve, një sistem i tillë i parimeve me vlerë mund të frymëzohet nga parimet shkencore, fetare ose filozofia morale e pavarur nga feja.¹⁵ Dhe gjithashtu, aspekti i veçantë shpirtëror dhe material i shoqërisë dhe i jetës individuale shpesh përfundon duke formuar botëkuptimin e tyre. Prandaj, kur bën një zgjedhje, është jetësore të shikosh dinamikën e botëkuptimit nga këndvështrimi i sistemeve të ndryshme shoqërore. Individët në një shoqëri mund të kenë parimet ose variacionet e tyre, por sjellja e tyre standarde do të ishte e prirur ndaj normave të miratuara nga shoqëria. Prandaj, çdo sistem total filozofik, mund të stilizohet në mënyrë të tillë që të nxjerrë pasoja praktike nga përbërësi teorik i tij. Kjo do të thotë se të gjitha zhvillimet, pasuritë, format e jetës apo edhe dëmet dhe krizat që vuajnë shoqëritë duhet të kërkohen pikërisht në këtë sistem total filozofik në të cilin ata besojnë.

Gjatë historisë hasim civilizime të ndryshme. Të gjitha këto civilizime kanë pasur një botëkuptim, nga i cili kanë marrë forma konkrete zhvillimi te popuj të ndryshëm, përfshirë civilizimin islam. Për ta kuptuar më mirë

13 Sejjid Muhammed nakin el-Attas, “Hyrje në metafizikën e Islamit: Paraqitja e elementeve themelore të botëkuptimit Islam” (Shkup: Logos-A, 2011) f. 7.

14 Charles H. Kraft, “Intercultural Communication and Worldview Change” (Pasadena, Calif.: School of World Mission, Fuller Theological Seminary, 1976), f. 1. Cituar nga Phil Parshall në “Muslim Worldview”, në www.encounteringIslam.org.

15 Pra, këtu kemi të bëjmë me tri mënyra të përgjithshme të perceptimit ose të interpretimit njerëzor të universit. Murtaza Mutahhari në librin e tij “Man and Universe” i cili në gjuhën shqipe është përkthyer si “Botëkuptimi Islam” shkruan për këto tri mënyra apo burime të konceptimit të botës: ai shkencor, filozofik dhe ai fetar. Këtu janë trajtuar aspektet e të tri mënyrave, përfshirë përparësitë dhe të metat, në veçanti dy llojet e para. Shih Murtaza Mutahhari, “Hyrje në botëkuptimin Islam”, f. 63-69.

këtë qytetërim, llojin e kulturës që ndërtoi dhe prototipin që synoi islami, do të ishte me vend të njiheshim me botëkuptimin që e ka formësuar atë, natyrën, specifikat dhe mbi të gjitha, se çfarë karakteri përmban ky lloj i botëkuptimi dhe çfarë vendi zë tani dhe në të ardhmen.

Botëkuptimi Islam

Feja përherë ka qenë një mënyrë me anë të së cilës njerëzit janë lidhur me universin dhe e kanë përmbushur fatin e tyre. Ajo vazhdimisht ka shërbyer si burim me ndikim në formimin e të menduarit dhe dhënies kuptim botës. Si çdo botëkuptim, përveç vlerave dhe karakteristikave që përmban, ajo gjithashtu ka një burim të caktuar nga i cili formohet dhe përcaktohet. Kur themi “botëkuptim islam”, kemi të bëjmë me një botëkuptim të ndryshëm nga botëkuptimet e tjera. Ky botëkuptim gjithashtu e ka burimin e tij, nga i cili e përcakton realitetin dhe nxjerr në pah shpirtin e tij të veçantë. Burimet nga rrjedh dhe formulohet botëkuptimi islam janë Kurani dhe Sunneti. Mënyra se si ne myslimanët e shohim botën, mënyrat tona të të menduarit, vlerat, konceptet tona dhe mënyra se si ne do ta përmbushim fatin tonë, përcaktohen nga këto dy burime. Prandaj, ky botëkuptim përfaqëson gjithashtu forcën motivuese, që përcakton natyrën e energjisë emocionale dhe psikologjike që lëviz shoqërinë dhe anëtarët e saj individualë, duke përcaktuar qëndrimet e tyre, veprimet e tyre dhe trajektoret e jetës së tyre, si dhe shkallën në të cilën jeta e tyre kontribuon për përparimin kulturor dhe rolin e tij në histori.

Botëkuptimi islam është plotësisht i përqendruar në një realitet dhe të vërtetë absolute (*el-hakk*) që është Zoti (*teuhid*). Zoti në botëkuptimin islam është qëllimi përfundimtar i gjithçkaje, Ai është realiteti absolut nga i cili manifestohen dhe varen të gjitha realitetet e tjera. Prandaj, në parim, burimet e botëkuptimit islam na njohin me doktrinën e njohjes së tij (*akīdeh*), domethënë të Zotit, dhe metodën (*sheri'ah*), mënyrën për të jetuar në harmoni me vizionin që përfiton nga njohja e tij. Doktrina, siç shprehet Husein Nasr, bën dallimin midis realitetit dhe asaj që duket reale, dhe metoda na ndihmon të bashkohemi me realen.¹⁶ Duke qenë se e vërteta përfundimtare mbetet thelbi i çdo botëkuptimi apo feje, atëherë islami këtë të vërtetë arrin ta përfitojë si për nga përmbajtja, edhe nga mjetet që ka. Nakib el-Attas, teksa prezanton karakteristikat dhe elementet

16 Sejjid Husein Nasr, “Ideale dhe realitete të Islamit” (Tiranë: Zemra e Traditës, 2008) f. 33.

themelore të botëkuptimit islam e përkufizon atë si “*vizion i realitetit dhe i së vërtetës*” që paraqitet para syrit të mendjes sonë duke na zbuluar se ç’është ekzistenca, për shkak se bota në tërësinë e saj është ajo që na e projekton islami.¹⁷ Është një vizion metafizik, një vështrim drejt botëve të dukshme dhe të padukshme në perspektivën e së cilës merret jeta si tërësi. El-Attasi bën edhe dallimin e qartë se si dallon botëkuptimi islam nga botëkuptimet e tjera. Ai vazhdon duke thënë se vizioni islam për ekzistencën nuk është një vizion që ndërtohet duke mbledhur koncepte, vlera nga kultura të ndryshme, as një botëkuptim që është formuar si një proces historik e zhvillimor i spekulimit filozofik dhe zbulimit shkencor, që do mund të ndryshohej sipas kohës dhe rrethanave. Ai nuk është një botëkuptim që i nënshtrohet proceseve dialektike, e as thjesht një botëkuptim që bazohet në të dukshmen dhe përvojën, por islami ofron një vizion i cili bazohet te “Shpallja” (*uahj*), konfirmohen nga feja (*din*) dhe pohohen nga parimet intelektuale e intuitive (*‘akl*).¹⁸ Shpallja është mesazhi i zbritur Muhammedit a.s, tek i cili edhe është zbuluar natyra absolute e Zotit. Është ky mesazh, i cili më pas përmes të Dërguarit, iu referohet të gjitha qenieve njerëzore, dhe që ka për synim ta zbulojë natyrën origjinale dhe të vërtetë të qenieve njerëzore. Kjo natyrë në perspektivën islame paraqet një gjendje origjinale dhe dhuntie, të cilën njeriu e mban brenda që me lindjen e tij dhe vetëm për aq sa arrin ta aktualizojë atë, për aq edhe do të arrijë ta njohë të vërtetën absolute. Kjo në islam njihet si “*fiṭrah*”. *Fiṭrah*, pra siç e përkufizon edhe el-Attasi do të thotë “*formë*” ose natyrë që Zoti ia ka dhënë çdo krijimi. Pra, ajo shpreh një model me anë të të cilit zë një vend përkatës në tërë krijimin, që do të thotë se çdo gjë ka një “*fiṭreh*”, një model ku zë një vend dhe luan një rol në ekzistencë. Shpallja është thirrje që njeriu të njohë pikërisht vendin e tij në rrethin e madh të ekzistencës, por në të njëjtën kohë, Shpallja na flet se asgjë përreth njeriut nuk është e kotë (*baṭil*), por se çdo gjë përreth dhe përtej tij ka një vend dhe kuptim ndaj të cilit njeriu është i thirrur ta njohë dhe të sillet në përputhje me to. Vetëm pasi njeriu t’i kthehet natyrës së tij, atëherë ai mund të jetojë në përputhje me vullnetin absolut të Zotit. Vullnet ky i cili në krijim manifestohet me

17 Sejjid Muhammed Nakib el-Attas, “Hyrye në metafizikën e Islamit: Paraqitje e elementeve themelore të botëkuptimit Islam” (Shkup: Logos-A, 2011) f. 12.

18 El-Attas, *po aty*, f. 12-15. *Të njëjtën gjë pobon dhe Husein Nasr duke thënë se perspektiva islame mbështetet në të shqyrtuarit e qenies hyjnore ashtu siç është në vetvete, e jo siç mishërohet në histori. Ajo mbështetet në absolutin e jo në “zbritjen e absolutit”. S. H. Nasr, “Ideale dhe Realitete”, po aty, f. 34-35.*

ligjet dhe format që Zoti i ka krijuar. Që njeriu të arrijë këtë harmoni me Zotin, ai ka nevojë për besim (*īmān*) dhe një lidhje të thellë dhe intime me Zotin, burimin e çdo gjëje. Besimi tek Zoti mbetet forca dhe arsyeja kryesore që do ta bënte njeriun të nënshtruar sinqerisht (*muslim*). Të gjitha veprimet dhe adhurimet (*‘ibādeh*), zgjedhjet (*ikhtijār*), njohuritë e tij (*‘ilm*) duhet të orientoheshin nga kjo lidhje, si përpjekje për ta forcuar lidhjen me Zotin (*ihsān*), në anën tjetër të shoqëruar me një frikë (*khauf*) se mos me ndonjë nga veprimet e tij, njeriu e shkëput këtë lidhje. Prandaj edhe besimtari duhet të vrapojë pas dijes me anë të së cilës do të mund t’i kuptojë sa më mirë gjërat, deri sa arrin në një njohje më reale për Zotin (*ma‘rifeh*), njohje të cilën ai mund ta arrijë duke njohur veten (*nefs*) dhe botën (*dunjā*). Kur njeriu e arrin këtë, atëherë veprimet e tij shoqërohen me një njohje, duke i i shndërruar në punë të mira (*‘amel es-sālih*) me anë të të cilave njeriu arrin të ruajë natyrën e tij dhe natyrën e gjërave përreth tij. Kështu, ai do të mundë t’i shmanget fatit të keq duke bërë shkatërrim në tokë (*fāsīd*).¹⁹

Botëkuptimi islam parimisht është një thirrje për individin që të fillojë të njohë vendin e tij në botë, dhe duke qenë se kjo botë në botëkuptimin islam nuk shprehet thjesht si botë fizike, por siç e thamë më sipër, paraqet nivele më të larta engjëllore dhe të botës së fshehtë (*ghajb*), ndaj myslimani është i thirrur ta përjetojë realitetin e ekzistencës në tërësi. Kjo arrihet kur ai përdor jo thjesht shqisat dhe mjetet teknike observuese, por edhe ndjesitë, emocionet, duke arritur deri te zemra (*kalb*), e cila në islam është organi që tregon se e vërteta mund të rrokët më realisht.

E gjithë kjo marrëdhënie e njeriut me Zotin si qenie absolute²⁰ dhe manifestimi i attributeve dhe emrave të Zotit (*eş- şife* dhe *el-esmā*) në ekzistencë (*meuxhūd*) arrihet nëse njeriu arrin të përmbushë kërkesën për njohje të drejtë (*‘ilm*). Ja pse të qenurit mysliman në të kaluarën ka qenë sinonim i të qenurit i ditur.

Krahas raportit të tij individual, myslimani më pas është i thirrur të jetojë me drejtësi (*‘adl*) edhe në raport me njerëzit e tjerë. Kjo përvojë fillon që në shtëpi, me prindërit tanë dhe njerëzit më të afërt që kemi. Më pas, kjo marrëdhënie shkon duke u shtrirë edhe më gjerë në shoqëri. Islami

19 Për domethëniet e këtyre termave etimologjikisht dhe kuptimet e tyre se si e shprehin mesazhin apo përceptimin e tërësishëm të botëkuptimit islam, të shihet vepra e Ali Ünal, “Kur’an’da Temel Kavramlar” (*Nil Yayınları: İzmir, 1999*).

20 Toshiko Izutsu, “God and man in the Qur’an/Semantics of the Qur’anic Weltanschauung” (Islamic Book Trust: Jalan Othman, 2002) f. 76 e tutje.

na mëson një sërë mënyrash se si duhet të jemi në raport me familjen, por edhe me shoqërinë. Respekti, mëshira, ndihma, zekati, sadakatu'l-fitri, vëllazëria, konsultimi, e shumë mënyra të tjera janë pasuri rrugësh të botëkuptimit islam se si njeriu mund të ndajë drejtësi me të tjerët, pa i bërë padrejtësi vetes dhe duke fituar edhe kënaqësinë (*riḍā*) dhe afërsinë (*ḱurb*) e Zotit. Ky raport i drejtë nuk mbaron vetëm me anëtarët e gjakut apo të shoqërisë që i përkasin fesë sonë apo edhe kombësisë, por islami pranon shumëllojshmërinë e kulturave dhe popujve, duke u bërë thirrje myslimanëve që edhe me ata duhet synuar të arrihet paqe, ndaj dhe islami na bën thirrje për dialog me ta.

Një tjetër aspekt i botëkuptimit islam është edhe kozmosi. Islami na mëson se çdo gjë e krijuar është një shenjë e Zotit (*ājeh*) dhe na bën thirrje se myslimani nuk duhet të jetojë indiferent ndaj natyrës. Format e meditimit, mendimit, hulumtimit, që na bën thirrje Zoti në Kuran tregojnë se njeriu pa iu qasur drejt dhe pa e njohur krijimin nuk do të ketë paqe dhe harmoni në tokë. Andaj, brenda kuadrin epistemik të islamit njohja e natyrës ka zënë një rol kyç. Në të kaluarën, në qytetërimin islam, krahas shkencave teologjike-filozofike dhe atyre juridike që kanë mundësuar një njohje më të drejtë të Zotit, edhe "*fikhu*" na ka mundësuar të arrijmë një raport më të mirë familjar e shoqëror, nëpërmjet lulëzimit dhe vlerësimit të shkencave ekzakte.

Përmbledhurazi, mund të themi se botëkuptimi islam është një vizion për botën, por jo thjesht si botë fizike, por edhe si botë metafizike që e thërret njeriun ta kuptojnë natyrën, origjinën dhe parimet që e bëjnë të ekzistojë këtë botë. Njeriut i janë dhënë kapacitetet dhe dhuntitë e duhura për ta perceptuar këtë realitet. Liria e tij do ta bëjë përgjegjës nëse ai vepron drejt karshi krijimit të Zotit apo sillet sipas egos së vet. Prandaj, botëkuptimi islam i jep një rëndësi tejet të madhe diturisë, si mjet për të kuptuar veten dhe natyrën e gjërave në krijim. Njohja e drejtë e vetes dhe e botës na çon te një njohje me e drejtë e Zotit. Kjo njohuri kërkon edhe një sjellje, e cila është në përputhje me atë që dimë (*edeb*). Brenda dijes për botën, nuk përfshihet vetëm natyra materiale e botës, por edhe bota tjetër (*ākhireh*). Andaj edhe veprimet tona nuk ndërtohen vetëm mbi dijen apo të mirën e kësaj bote, por edhe mbi natyrën dhe pritshmëritë e natyrës së botës tjetër. Kur njeriu e arrin këtë, atëherë më në fund ai ka arritur lumturinë (*se'ādeh*) në këtë botë dhe shpëtimin (*felāh*) në botën tjetër.

E Ardhmja e qytetërimit islam

Ahmet Davutollu teksa pyet se me anë të cilës forcë një qytetërim mund të lindë apo rilindë përballë forcave qytetërimore në fuqi, përgjigjet duke thënë se kjo forcë është pikërisht vetëpërceptimi:

“Elementi themelor që siguron krijimin e qytetërimeve, ngritjen e tyre, rezistencën kundër hegjemonisë potenciale të qytetërimeve të tjera dhe shfaqjen e prototipit të një qytetërimi është vetëpërceptimi. Faktori final që mundëson formimin e vetëpërceptimit nuk është fusha institucionale dhe formale (zyrtare) por botëkuptimi, i cili çështjen e ekzistencës së njeriut e vendos në një kornizë kuptimplote”.²¹

Ai vazhdon duke thënë se për sa kohë ky vetëpërceptim mbetet i paprekshëm, shpirti i një qytetërimi mund të vazhdojë të jetojë, pavarësisht ndryshimeve të jashtme që mund të ketë pësuar. E rëndësishme është të ruhet shpirti, pra vetëpërceptimi, çfarë e bën atë qytetërim të jetë një qytetërim. Vetëpërceptimi i një qytetërimi mund të formohet vetëm e vetëm në saj të një vetëdijeje më të gjerë për ekzistencën, si dhe në bazë të diturisë dhe tërësisë së normave të sjelljes më përfshirëse. Sipas kësaj logjike kuptojmë se çdo qytetërim ekziston për aq kohë sa vetëpërceptimi i tij mbetet i freskët, dhe në anën tjetër ato qytetërimet që e humbin këtë freski vetëpërceptimi dalëngadalë fillojnë të rrënohen.²²

Megjithëse kushtet e jetës njerëzore, si dhe njohuritë njerëzore, potencialet, nevojat dhe sfidat, janë në një gjendje fluksi dhe evolucioni të vazhdueshëm, zbatimet e vlerave dhe koncepteve islame gjithashtu duhet të ndryshojnë dhe evoluojnë në përputhje me realitetet e jetës njerëzore, të cilat ndryshojnë nga një epokë në tjetrën dhe ndryshojnë nga një vend në tjetrin.²³ Njeriu dhe bota përreth tij ndryshojnë, por përsëri ky ndryshim ndodh brenda disa të vërtetave që janë të pashmangshme dhe që vazhdojnë ta përcaktojnë fatin tonë. Ndaj, individit mysliman apo shoqëria në tërësi (*umme*) kërkohet të reflektojnë për këto të vërteta të pandryshuara dhe në anën tjetër të kuptojnë edhe shkallën e vërtetë se sa larg këtyre normave kemi shkuar. Një përpjekje e tillë që në traditën islame njihet si “*ixhtihād*”²⁴ ka

21 Ahmet Davutoglllu, “Vetëpërceptimi i qytetërimeve” (*Shkup: Logos-A, 2002*) f. 27-28.

22 Ahmet Davutoglllu, “Vetëpërceptimi i qytetërimeve”, po aty, f. 31.

23 Abdulhamid Abu Sulayman, “The Quranic Worldview”, po aty, f. 64.

24 Ne këtu “*ixhdihadin*” nuk e kemi përdorur për qëllim definicionin në fushën e fiktit që nënkupton deduktimin e normave juridike, por si proces i gjithanshëm i cili na ndihmon të ripërcaktojmë gjendjen tonë dhe gjendjen e botës përreth nesh, për të treguar se sa në harmoni me të vërtetën jemi.

qenë forca dinamike e mendimit dhe e veprimit të myslimanëve përgjatë historisë. Përmes këtij procesi, botëkuptimi islam ka mbetur i gjallë, aktual dhe njëherësh iu ka mundësuar myslimanëve të ruajnë lidhjet me rrënjët e tyre qiellore, duke mos eanashkuar fatin, nevojat dhe përgjegjësitë e kësaj bote. Kjo për arsye, sepse vetë kjo botë shpreh një realitet, një vullnet dhe urtësi të Zotit. Në mënyrë që myslimanët edhe njëherë të mund të ndërtojnë një jetë në përputhje me vizionin e botëkuptimit islam, atëherë duhet të kenë parasysh se kemi nevojë për:

“...një kuptim të natyrës së Kur’anit dhe Sunetit, një njohje e natyrës njerëzore dhe ligjeve të kozmosit, dhe një vetëdije për rrethanat e njerëzve të veçantë me potencialet dhe sfidat... Këto vlera dhe parime përfaqësojnë blloqet themelore, thelbësore të ndërtimit me anë të të cilave botëkuptimi Kur’anor manifestohet në nivelin praktik. Ato formojnë mentalitetin e komunitetit mysliman dhe të myslimanit individual, të cilët më pas i përkthejnë ato në realitete konkrete. Në këtë mënyrë, ata drejtojnë përparimin kulturor të shoqërisë - duke furnizuar anëtarët e saj me forcën, vullnetin dhe energjinë e nevojshme për të qenë efektivë në performancën e tyre, për të arritur qëllimet e tyre dhe për t’u rritur dhe zhvilluar në mënyrë të tillë që ata ecin në hap me rrethanat, potencialet dhe sfidat në zhvillim dhe zhvillimin e njohurive dhe kuptimit të njerëzimit për botën”.²⁵

Ne mendojmë se nuk do të ketë sjellje të shëndosha dhe kulturë islame nëse vizioni i këtij botëkuptimi nuk bëhet i qartë tek anëtarët e tij. E kaluara ka një rëndësi të madhe dhe është një fakt i suksesit të një përpjekjeje reale për ta realizuar këtë botëkuptim. Por ne sot kemi rënë në sistemet e të menduarit dhe të vepruarit të botëkuptimit sekularist, që e ka zbehur kaq shumë, jo vetëm botëkuptimin islam, por edhe po zhdruk një sërë kulturash²⁶ e qytetërimesh. Myslimanët, përmes procesit të tyre të të menduarit duhet të kërkojnë një paradigmë të llojit të vet, siç do thoshte Davutollu, dhe jo të shikojnë veten dhe botën me “thjerrëza” që e ngufasin botëkuptimin islam.²⁷ Në anën tjetër, ajo çfarë mund të shikohet

25 Abdulhamid Abu Sulayman, “The Quranic Worldview”, po aty, f. 66-73.

26 Për ndikimin e sekularizmit në kulturën dhe qytetërimin islam dhe pasojat që janë shënuar në botën islame të mendimit, artit, urbanistikës, mjedisit, tregjeve, arsimit etj., të shikohet vepra e Sejjid Husein Nasr, “Islami në botën moderne/I sfiduar nga Perëndimi, i kërcënuar nga fundamentalizmi, besnik ndaj traditës” (Logos-A: Sbkup, 2019). Përkatësisht kreu VII, VIII, XXII, XIII, XIV.

27 Ahmet Davutoglu, “Alternative Paradigm/The impact of Islâmic and Western Weltanschauung on political theory” (University Press of America: Maryland, 1994) f. 47 e tutje.

nga shoqëria e sotme myslimane është veçse një komunitet i copëtuar, i ndarë, në të cilin shumica e studiuesve tanë jetojnë në një fushë, shumë të tjerë intelektualë në një fushë tjetër dhe shumica e njerëzve tanë janë laikë - shumë prej të cilëve ose janë të izoluar, të tjetërsuar, injorantë, të mashtruar, ose viktimë të besëtytnisë së gradës.²⁸

Në fund mund të themi se nëse vlerat dhe konceptet që përcjell një botëkuptim i japin formë jetës së një individi dhe shoqërie, atëherë ne mendojmë se kriza jonë qëndron pikërisht në mënyrën se si i mësojmë këto vlera dhe koncepte. Nëse konceptet nuk bëhen aq të qarta dhe nuk ndërtojnë një vizion të qartë të popullit, atëherë botëkuptimi humb efektin dhe motivin e vet në një jetë reale, e cila mund të degdiset sipas këtij botëkuptimi. E ardhmja jonë si myslimanë varet nga një ndërmarrje e tillë. Arsyeja kryesore pse institucionet myslimane të ne nuk arrijnë një gjuhë mirëkuptimi dhe bashkëpunim të ndërsjellë është pikërisht fragmentalizimi i botëkuptimit islam. Integrimi i këtij botëkuptimi, edhe një herë në vlera dhe koncepte me një semantikë të gjerë kuptimesh, do t'i bënte më të qarta nevojat dhe qëllimet reale që kanë xhamitë, universitetet, shkollat, institucionet, familja, edukimi etj. Teksa besimtarët dinë dhe luajnë rolin e tyre në vendet përkatëse, sipas udhëzimit që paraqet libri i Zotit dhe mësimet e Pejgamberit a.s., atëherë të gjithë do të jemi duke ngritur hallkat e një veprimtarie të përditshme që bazohet në realitetin e islamit.

28 Abdulhamid Abu Sulayman, "The Quranic Worldview", *po aty, f. 100*.